



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 547/2 Prot

Tiranë, më 19.11.2020

V E N D I M

Nr.153, datë 19.11.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit nr. 97/1 (44/11prot.), datë 12.06.2020, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për largimin nga shërbimi civil të nëpunëses **.***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procesit të verifikimit të një kërkesë të paraqitur nga nëpunësja e Bashkisë Tropojë, *****.

Vërej se:

Nëpunësja e Bashkisë Tropojë *****, nëpërmjet një kërkesë të protokolluar me nr. 547 prot., datë 18.06.2020, ka parashtruar pretendimet e saj se në procedimin disiplinor, përmyllur me aktin administrativ nr. 97/1 (44/11prot.), datë 12.06.2020, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, janë kryer shkelje ligjshmërie, të cilat kanë ndikuar në marrjen e një vendimi të padrejtë, për largimin e saj nga shërbimi civil e për këtë arsye ka kërkuar ndërhytjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Pas marrjes së informacionit të mësipërm ka filluar verifikimi paraprak i këtij rasti, prej nga ka rezultuar:

Komisionit të Disiplinës, ngritur me urdhrin nr. 237 (3135 prot.) datë 30.10.2019, “Për ngritjen e Komisionit të Përhershëm Disiplinor në Bashkinë Tropojë”, i ndryshuar, në

përfundim të diskutimeve, vlerësimit të dosjes individuale të nëpunëses në fjalë, verifikimit të pretendimeve të nisura në formë shkresore, (*pasi në procesverbalin mbajtur me këtë rast, është shënuar që punonjësja nuk është paraqitur në seancën dëgjimore të datës 27.05.2020*), ka arritur në përfundimin se punonjësja *****, gjatë periudhës Janar -Dhjetor 2019, gjatë kryerjes së detyrave të saj si Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës, ka kryer shkelje disiplinore shumë të rënda, të cilat konsistojnë, sidomos në:

- moszbatimin e kontrollit dhe disiplinës finansiare për përdorimin e vlerave materiale dhe monetare;
- mosrespektimin e limiteve të përcaktuara në ligj për kufirin minimal të të ardhurave me qëllim miratimin e buxhetit vjetor, duke mos pasqyruar gjendjen e faturave të palikujduara në vite dhe mosmarrjen e masave për hartimin e një grafiku për likuidimin e tyre duke ndjekur radhën për të gjitha vitet që nga 2015 e në vazhdim;
- planifikimin dhe lidhjen e kontratave pa fond në dispozicion; mosrespektimin e procedurës për menaxhimin e riskut, si detyrë funksionale e përgjegjësit të sektorit të buxhetit dhe financës;
- moskryerjen e analizave të punës për realizimin e buxhetit paraardhës, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet e buxheteve në vite.... etj. shkelje të cilat janë klasifikuar sipas pikës 2/a, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Disiplinës, në përfundim të procedurës, nëpërmjet aktit administrativ nr. 97 (44/10prot.), datë 08.06.2020, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, ndaj punonjësës në fjalë.

Ndërkaq, gjatë kryerjes së procesit të verifikimit të këtij rasti, Komisioneri nëpërmjet shkresës me nr. 606/1, datë 21.09.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ka rënë në dijeni të faktit se nëpunësja në fjalë, në datën 14.09.2020, i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në themel, e cila ka filluar shqyrtimin e çështjes.

Nisur nga sa më sipër, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr.8116, datë 29.3.1996, “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, sipas të cilit institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se në këtë rast, nuk duhet të vijojë më tej hetimi administrativ, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, e cila do të vendosë edhe për zgjidhjen e pasojave të aktit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit

nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të regjistruar me *nr. 547 prot., datë 18.06.2020*, në lidhje me largimin nga shërbimi civil të nëpunëses ******, dhe arkivimin e çështjes, pasi rasti është duke u shqyrtuar nga Gjykata.*
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Tropojë dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha